

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gara për kreun e Gjykatës së Lartë: Gjyqtari Ilir Panda dorëzon kandidaturën
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/gara-per-kreun-e-gjykates-se-larte-gjyqtari-ilir-panda-dorezon-kandidatu-i585382
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 11:32:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 11:30:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c598f7ebedd54be732e1b39c9c318612aa7382c8eb89b0a3e4e7b42dda40289b
TEKSTI	e5f9a6e0b1fdb4dc391c9c7c4a33baf0301e6dbd1f3d6a3bf2ade2212d9b0a17
PAMJA	4c4efefe7dde9622c012fdd8b7fe8b3373d88b0573305d1ca35c224ca20b56e1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fa8c4c0e1f5a2b3d45201f1cde719a38bb4b8703691f4f9bf0a3e24ccae7a56d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	edfed3cd86f7048b6622657648b993749a8a23a92bfae9d609e7fe0135b574af
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fa8c4c0e1f5a2b3d45201f1cde719a38bb4b8703691f4f9bf0a3e24ccae7a56d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Gara per kreun e Gjykatës së Lartë: Gjyqtari Ilir Panda dorezon kandidaturen](#)U largua nga Ministria e Brendshme, Lamallari: Do ta vijoj angazhimin si pjese e ekipit te Ra fundit

Gara për kreun e Gjykatës së Lartë: Gjyqtari Ilir Panda dorëzon kandidaturën



11 Shtator 2026, 13:30Kronika TEMA



Ilir Panda pjesë e shkallës së tretë të gjyqësorit prej 11 marsit të vitit 2020, ka shprehur interes për drejtimin e Gjykatës së Lartë. Ky i fundit është zgjedhur zëvendëskryetar në 16 nëntor të vitit 2023 nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Gara për kryetarin e Gjykatës së Lartë u hap në mes të muajit gusht, pasi mandati 3-vjeçar i Sokol Sadushit përfundon në 17 tetor.

Sot është afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, ndërsa të drejtë kandidimi kanë vetëm gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Pritet deri në 24.00 për të parë nëse do të ketë magistratë të tjerë të interesuar për këtë pozicion, ndërsa kryetari i ri që do të zgjidhet do të nisë ushtrimin e detyrës në 18 tetor të këtij viti duke garantuar vijimësinë institucionale.

Ilir Panda është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në vitin 1986, si dhe ka kryer disa kualifikime pasuniversitare të organizuara nga institucione shqiptare, evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mban gradën shkencore “Doktor”.

Ka punuar në disa sektorë të drejtësisë, duke filluar në organet e ndjekjes penale, në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, si avokat, si pedagog në Shkollën e Magjistraturës dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë. Ka qenë ministër i drejtësisë, në vitet 1999-2000 dhe Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në vitet 2003-2007.

Ka marrë pjesë si autor në shumë grupe pune për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, për hartimin e komenteve, manualeve, buletineve, si dhe në projekte të rëndësishme në fushën e të drejtës. Është autor i shumë artikujve në fushën e të drejtës në disa revista shkencore dhe profesionale, si dhe i përkthimeve të ndryshme.

Panda ka qenë, gjithashtu, Këshilltar Ligjor i Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë, ekspert lokal i Unicef, i Këshillit të Evropës dhe i organizatave të tjera. Ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë, në vitet 2002-2007, anëtar i Këshillit të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, anëtar i Këshillit Drejtues të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” dhe anëtar i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Pse më sheh” - Vrasja e 24-vjeçarit në Shkodër, gjykata lë në burg Andri Vulajn!](#)

13:20 Kronika

Shiste mallra të kontrabanduara - Durrës, arrestohet pronari i dyqanit

13:00 Kronika

[Ngërçi me pagat në drejtësi, gjykata urdhëron Thesarin të procesojë listëpagesat e GJKKO-së](#)

12:55 Kronika / 5 komente

[Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.